



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
- *Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije -- Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Kabineti i Ministres / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Numër: 01B/482
Datë: 16.11.2022

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në mbështetje nenit 8 të Rregullores (QRK) - nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e datës 30.03.2021, shtojcës 1 paragrafi 7 dhe pikës 4.2 të Vendimit me Nr. 13-19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 14.07.2021 dhe vendimit nr. 14/106 të datës 09.11.2022, hap këtë:

THIRRJE

Për mbështetje financiare të studenteve në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (apo STEM) të arsimit të lartë në Kosovë

Thirrja synon ta mbështesë shkollimin e studenteve që studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë në programet e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (apo STEM në gjuhën angleze), në vlerë prej 1000 (njëmijë) EUR/vit për student.

PËRSHTATSHMËRIA E KANDIDATEVE PËR APLIKIM

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentet që regjistrohen në një nga programet e fushave STEM në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë në Kosovë, sipas aneks-listës së programeve të publikuar me këtë thirrje. Përparësi kanë kandidatet që kanë përfunduar me sukses vitin paraprak dhe kanë regjistruar për herë të parë vitin akademik 2022-2023.

Kjo formë e mbështetjes financiare ka për qëllim të promovojë pjesëmarrjen e vajzave/grave në fushat STEM. Në këtë thirrje inkurajohen që të aplikojnë studentet nga komunitetet jo-shumicë, ata me aftësi të kufizuar dhe ata që vijnë nga zonat rurale.

PROCESI I APLIKIMIT

Procesi i aplikimit do të realizohet online përmes platformës E-Kosova.

Për të aplikuar, kandidatët duhet të plotësojnë këtë dokumentacion:

1. Jetëshkrimi (CV-ja);
2. Dëshmia/vërtetimi i pranimi të aplikuesit në një nga programet STEM të universitetit përkatës;
3. Fletëregjistrimi nga institucioni i arsimit të lartë publik;
4. Diploma e shkollës së mesme të lartë (vlen vetëm për studentët e vitit të parë);
5. Pasqyra e notave (vlen vetëm për studentët e vitit 2 dhe 3);
6. Nëse aplikohet, formulari i vetëdeklarimit (për komunitetet jo-shumicë);
7. Nëse aplikohet, dëshmitë relevante të lëshuara nga organet kompetente për asistencë sociale dhe personave me aftësi të kufizuara sipas kushteve për aplikim dhe përparësive në konkurrim.

Kushtet dhe kriteret për aplikim

1. Të jenë shtetas i Republikës së Kosovës;
2. Të kenë të përfunduar shkollimin e mesëm në njërën nga shkollat e mesme të larta të Republikës së Kosovës;
3. Të kenë të regjistruar vitin akademik për herë të parë;
4. Llogaria bankare personale (në emër të aplikuesit) dhe aktive, në njërën nga Bankat e Republikës të Kosovës;
5. Të kenë të përfunduar me sukses vitin paraprak, me notë mesatare së paku 8 (vlenë për studentët e vitit të 2 dhe 3);
6. Të drejtë aplikimi kanë vetëm studentet e rregullt;
7. Të drejtë aplikimi nuk kanë studentet të cilët e kanë përsëritur vitin e studimit;
8. Të drejtë aplikimi nuk kanë studentët të cilët kanë përfituar nga skemat për mbështetje financiare nga MASHTI në vitin akademik 2022/2023;
9. **Thirrja është e hapur për të gjitha vajzat/gratë në bazë të kriterëve më lartë dhe për djem/burra të vitit të dytë dhe tretë në bazë të kriterëve më lartë.**

Aplikacionet e pakompletuara refuzohen në fazën e parë të vlerësimit teknik.
Konkursi është i hapur nga 23.11.2022 deri më 07.12.2022 në ora 16:00.

Arbërie Nagavci

Ministër e MASHTI-t



ANEKS-LISTA E PROGRAMEVE STEM

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”			
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
1	Prodhimi Shtazor	Prishtinë	BSc
2	Prodhimi Bimor	Prishtinë	BSc
3	Teknologji Ushqimore me Bioteknologji	Prishtinë	BSc
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit			
1	Inxhinieria e mjedisit	Prishtinë	BSc
2	Konstruktiv	Prishtinë	Bsc
3	Hidroteknik	Prishtinë	BSc
4	Gjeodezi	Prishtinë	BSc
Fakulteti i Arkitekturës			
1	Arkitekturë	Prishtinë	BSc
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike			
1	Elektroenergjetikë	Prishtinë	BSc
2	Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë	Prishtinë	BSc
3	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	Prishtinë	BSc
4	Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike	Prishtinë	BSc

Fakulteti i Matematikës dhe Shkencave të Natyrës				
1	Biologji	Prishtinë		BSc
2	Kimi	Prishtinë		BSc
3	Kimi Inxhinierike	Prishtinë		BSc
4	Shkencë Kompjuterike	Prishtinë		BSc
5	Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit	Prishtinë		BSc
6	Gjeografi	Prishtinë		BSc
7	Fizikë	Prishtinë		BSc
8	Matematikë	Prishtinë		BSc
9	Matematikë Financiare në Banka dhe Siguri	Prishtinë		BSc
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike				
1	Mekatronikë	Prishtinë		BSc
2	Komunikacion dhe Transport	Prishtinë		BSc
3	Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërishme	Prishtinë		BSc
4	Dizajn Inxhinierik dhe Automjete	Prishtinë		Bsc

5	Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment	Prishtinë		BSc
---	--	-----------	--	-----

Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"

<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>		<i>Niveli i studimeve</i>
1	Teknologji	Mitrovicë		Bsc
2	Inxhinieri dhe tekonojgi ushqimore	Mitrovicë		Bsc
3	Xehtari	Mitrovicë		Bsc
4	Gjeologji	Mitrovicë		Bsc
5	Materiale dhe Metalurgji	Mitrovicë		Bsc
6	Inxhinieri Ekonomike	Mitrovicë		Bsc
7	Makineri Prodhuese	Mitrovicë		Bsc
8	Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri	Mitrovicë		BSc

Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"

<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>		<i>Niveli i studimeve</i>

1	Agromjedis dhe Agroekologji	Pejë		BSc
2	Teknologji Ushqimore	Pejë		BSc
3	Teknologji e Prodhimit Bimor	Pejë		BSc

Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"

<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>		<i>Niveli i studimeve</i>
1	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi	Prizren		BSc
2	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi - Boshnjakisht	Prizren		BSc
3	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi - Turqisht	Prizren		BSc
4	Shkencat e Pyjeve dhe të Mjedisit	Prizren		BSc
5	Agrobiznes	Prizren		BSc

Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka"

<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
1	Shkenca Kompjuterike	Gjilan	BSc

Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Ferizaj

<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
1	Inxhinieria Industriale me Informatikë	Ferizaj	BSc
2	Informatika e Aplikuar	Ferizaj	BSc